

KANDIDAT I PA VARUR
ASTRIT ABEDIN DERVISHI
MEMALIAJ

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE REGJISTRUAR

**Per Auditimin Ligjor të Fondeve të përfituara
Për Fushatën Zgjedhore 2015**

Tirane 25 Tetor 2015



RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

KOMISIONINI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Bulevardi: “Dëshmoret e Kombit”
Pallati i Kongreseve, Tirane

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.969, dt.10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës të Shërbimit Nr.7713, dt.29.09.2015, kam audituar pasqyrat bashkëlidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, që fillon me datë 21.05.2015 me regjistrimin e Kandidatit të Pavarur Z. Astrit Abedin Dervishi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 20.06.2015 me përfundimin e fushatës zgjedhore të 21 Qershor të vitit 2015.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e Kandidatit të pa Varur z. Astrit Abedin Dervishi. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur mbi bazën e arketimeve dhe pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posacëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.



“FILTO Auditing” sh p k.

Kandidati i Pavarur z. Astrit Abedin Dervishi ne baze te Deklarates se tij te dates 07.10.2015 nuk ka përfituruar fonde per fushaten zgjedhore dhe nuk ka kryer shpenzime për fushatën zgjedhore që fillon me dt.21.05.2015 dhe mbyllet me dt. 20.06.2015 .

“FILTO Auditing” sh p k

Tirane më 15 Tetor 2015

Tatjana FILTO

